

## **KLSH merr pjesë në workshop-in e zhvilluar në Ankara për auditimin financiar**

Nga data 26 deri në datën 30 nëntor 2018, në Ankara të Turqisë, në zyrat e Gjykatës Turke të Llogarive, audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit morën pjesë në Workshop-in mbi vlerësimin e gjetjeve dhe raportimin e Auditimit Financiar në Sektorin Publik.

Ekipi përfaqësues i Kontrollit të Lartë të Shtetit përbëhej nga z. Enea Caushaj, z. Jovan Plaku Auditues në Departamentin e Auditimit të Vetqeverisjes Vendore dhe z. Agim Mandri Auditues në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

Në këtë aktivitet morën pjesë Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Gjykata Turke e Llogarive, Zyra e Auditimit të Institucioneve të Bosnje-Hercegovinës, Zyra Kombëtare e Auditimit të Maqedonisë, Institucioni Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi dhe Institucioni Shtetëror i Auditimit të Serbisë.



Qëllimi i këtij Workshop-i, mbështetur edhe në moton e INTOSAI-t “*Experientia mutua omnibus prodest* (Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë)”, ishte shkëmbimi i ekperiencës dhe praktikave më të mira për sa i përket formulimit dhe vlerësimin të gjetjeve dhe raportimit të auditimit financiar në sektorin publik. Kjo qasje bëri të mundur nxjerrjen në pah të pikave të forta dhe pikave ku shihet mundësia për përmirësime në aspektin strukturues dhe raportues të auditimit financiar. Rastet studimore të trajtuara dhe më pas të diskutuara në mënyrë konstruktive bashkarisht nga secili prej gjashtë ekipeve përfaqësuese të SAI-ve të sipërpërmendur, vunë në dukje metodologjitë dhe qasjet që ekzistojnë në një projekt auditimi, duke u nisur që nga planifikimi i auditimit, përcaktimi i riskut e materialitetit dhe deri në klasifikimin e gjetjeve dhe formulimi i raportit përfundimtar duke dhënë dhe rekomandimet e nevojshme.



Nga ana e përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit u prezantua nga z. Enea Caushaj, auditues i Departamentit të Auditimit të Vetqeverisjes Vendore, një pamje e përgjithshme rreth kuadrit ligjor raportues në Republikën e Shqipërisë, strategjisë së menaxhimit të financave publike dhe roli monitorues i KLSH-së, si anëtar kyç i Komitetit Drejtues për Menaxhimin e Financave Publike, për sa i përket progresit të masave të përcaktuara në këtë Strategji.



U prezantua dhe baza ligjore mbi të cilën funksionon Institucioni Suprem i Auditimit në Republikën e Shqipërisë si dhe strategjia 5 vjeçare e zhvillimit të tij 2018-2022.

Për sa i përket Strategjisë, theksi u vu tek qëllimi i parë i saj, *“Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të”*, si dhe në 2 nga 10 objektiva që e përmbushin atë, përkatësisht, *“Auditimi mbi bazë risku”* si dhe *“Kryerja e Auditimit Financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit”*.

Trajtimi i këtyre objektivave u pa me interes nga SAI-et pjesëmarrëse ku u diskutua dhe vizioni e nevoja për rritjen e kapaciteteve në auditimet financiare dhe në auditimet e teknologjisë së informacionit.

Finalizimi i Workshop-it u arrit me disa konkluzione rreth metodave, qasjeve, strukturimeve dhe formulimeve në raportimin e auditimit financiar, duke përfituar nga eksperiencia e përbashkët mes Institucioneve Supreme të Auditimit pjesëmarrëse.